



Plamuar / Dorezuar Prilidjenj/Prodato Received/Delivery	07-09-2022	2 viti god years	
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SAMBACE	5211/2022		014



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.441/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.1143/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.441/2021 të datës 24.05.2021 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson me adresë rruga në Prishtinë, kundër organit të punësimit/Komuna e Dragashit, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur më datë 07.09.2022, mori këtë:

### V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.441/2021 e datës 24.05.2021 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi i datës 14.05.2021 i Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Dragashit.

### A r s y e t i m

Ankuesi përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, me datë 24.05.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 2583/2021 të regjistruar me numër A.nr.441/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensimin e dy pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe tri pagave jubilarë, sipas Kontratës së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, me datë 01.06.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Komunën e Dragashit. Këshilli, me datë 11.06.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në mungesë të kuorumit për vendosje më datë 08.07.2021 ka njoftuar përfaqësuesin e ankuesit lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës dhe ka udhëzuar të njëjtin që t'i ndjek procedurat e mëtejme në pajtim me Ligjin për Konfliktet Administrative. Ankuesi ka ndjekur procedurat gjyqësore duke hapur konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, më datë 01.08.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1143/2021 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke e anuluar njoftimin e Këshillit të datës 08.07.2021 dhe duke e detyruar Këshillin që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 24.05.2021 të ankuesit.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokollit 2583/2021 të regjistruar me numër A.nr.441/2021 të datës 24.05.2021e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 19.05.2021; Kërkesën e parashtruar nga ankuesi më datë 15.03.2021 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Dragashit; Vendimin nga Shërbimi i Personelit i Komunës së Dragashit i datës 14.05.2021; Vendimin e datës 30.06.2015 nga Menaxheri i Personelit për ankuesin; Librezën e punës; Vendimin e datës 12.05.2018 nga Shërbimi i Personelit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për ankuesin; Vendimin e datë 16.07.2018 nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Akt Emërimit e datës 01.01.2012 për ankuesin; Listën e pagave qershor, maj 2018; dhe Përgjigjen në ankesë e datës 11.06.2021; Njoftimin e datës 08.07.2021 dhe Aktgjykimin A.nr.1143/2021 të datës 01.08.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, *është e pa bazuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht Akt Emërimit e datës 01.01.2012 është konstatuar se ankuesi ka qenë i punësuar në pozitën Zyrtar për Shërbime Sociale pranë Komunës së Dragashit. I njëjti në bazë të Vendimit të datës 12.05.2018 i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit me datë 12.05.2018. Te njëjtit përmes këtij vendimi i është njohur e drejta e kompensimit të një page me rastin e pensionimit sipas Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë.

Ankuesi më datë 15.03.2021 ka parashtruar kërkesë të Menaxheri i Personelit dhe Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave pranë Komunës së Dragashit, për kompensimin e dy pagave në emër të pagave përcjellëse dhe tri pagave në emër të shpërblimit jubilar me sipas Kontratës së Përgjithshme Kolektive të Kosovës. Udhëheqësi i Personelit i Komunës së Dragashit, me datë 14.05.2021 me vendim i është përgjigjur ankuesit në kërkesën e tij të datës



15.03.2021 duke e njoftuar që kompensimi me rastin e pensionimit i është bërë në pajtim me Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet e Tjera të Nëpunësve Civil me c'rast i njëjti ka marr një pagë të njëhershme në vlerën e 470 euro, ndërsa në pajtim me këtë rregullore ka përfituar edhe 25% të pagës mesatare në emër të shpërblimit jubilar.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që t'i njihet e drejta e kompensimit të dy pagave mujore dhe tri pagave jubilarë me rastin e pensionimit sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar bazën ligjore mbi të cilën janë ngritur pretendimet ankimore të ankuesit, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.38/2014 të datës 18.06.2014, ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015 dhe e njëjta sipas nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ka qenë e zbatueshme në periudhë jo me shumë se tri (3) vjet, respektivisht deri me datë 31.12.2017. Kolegji, po ashtu ka konstatuar se Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social, dhe njeherit nënshkruese e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, me datë 15.09.2017 është tërhequr nga zbatimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, dhe rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, pas datës 31.12.2017, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit për realizimin e kompensimit të dy pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe tri pagave jubilarë, mbi këtë bazë ligjore, është i pazbatueshëm, sepse ankuesi ka arritur moshën e pensionimit me datë 12.05.2018 në kohën kur nuk ka qenë e aplikueshme Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës.

Kolegji i Këshillit bazuar në konstatimin si me lartë vlerëson se Kryetari i Komunës së Dragashit, me rastin e nxjerrjes së Vendimit të datës 12.05.2018 përmes të cilit ankuesit me rastin e pensionimit ia ka njohur të drejta e kompensimit të një page përcjellëse në vlerën e pagës së fundit, ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 22 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, si dhe dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë, përkatësisht nenin 19 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *"Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën prej një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit"*. Po ashtu është konstatuar se me listën e pagave të muajit korri 2018 ankuesit i është paguar shpërblimi i përvjetorit (jubile) në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil, gjegjësisht 92 euro, siç përcaktohet me nenin 22 paragrafit 2 nën paragrafit 2.2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, dhe nenin 21 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë. Kështu që Vendimi i datës 14.05.2021 i Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Dragashit është nxjerr në pajtim me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, dhe Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë, ndërsa pretendimet ankimore të ankuesit për realizimin e edhe të dy pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe tri pagave jubilarë, sipas Kontratës së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, janë të pazbatueshme.



Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqësor për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nën 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQËSOR PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.441/2021**

**Avdyll BEKTESHI**

*Avdyll Bekteshi*  
Procesmbajtës

**Jeton KOCA**

*Jeton Koca*  
Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dorëzohet:**

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Dragashit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Dragashit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

